1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës

1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.

2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet

para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
- b) garanci bankare
- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

25. Procedura e ankesës

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për

Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.

2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:

a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;

b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;

c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;

d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;

e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës [Ekonomike](#)

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit.

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimimit.

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi -të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
 - (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontratës;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë** (në rast BOE): _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës Ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

1	2	3	4	5	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					

Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

like ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objektështë i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6.

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor*]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Mirembajtja duhet te perfshije garantimin e sherbimit te sistemit pa nderprerje, sistemin e problemeve ne funksionalitete, perditësimi sipas ndyshimeve ne legjislacion, auditin per sigurin e sistemit etj. Kompania e cila do te beje mirembajtjen e sistemit duhet te ofroje support sipas parishikimit ne kontrate me maksimumin 2 ore kohe pergjigje me mail dhe ne raste emergjente kur problem nuk mund te zgjidhet ne distance me 4 ore kohe pergjigje ne vend

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet: SIPAS TERMAVE TE REFERENCES

Afatet e ekzekutimit:

Sherbimet	Pershkrimi	Vendi i ekzekutimit	Afati i ekzekutimit
1	Blerje liçensa perdorimi 1 vjeçare per Flare ERP	SHRUK Durres	24 ore nga nenshkrimi i kontrates
2	Krijimi i site Disaster Recovery ne cloud	Cloud	48 ore nga nenshkrimi i kontrates
3	Mirembajtja e sistemit FLARE ERP	SHRUK Durres	12 muaj nga nenshkrimi i kontrates

Licensat duhet te dorezohen dhe instalohen brenda 24 oresh nga nenshkrimi i kontrates. Ato duhet te jene te vlefshme deri ne perfundim te kontrates. Site disaster recovery ne cloud duhet te krijohet brenda 48 oresh nga nenshkrimi i kontrates. Periudha e mirembajtjes eshte 12 muaj dhe nis me nenshkrimin e kontrates. Orari i punes do te jete e Hene – e Premte ora 8:00 – 16:00 duke perjashtuar festat zyrtare.

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCES

1. HYRJE

Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Durres sha perdor sistemin FLARE ERP e perbere nga modulet FLARE Billing dhe Mobiread (qe sherben per te lexuar matesat e abonenteve, per te menaxhuar te dhenat e tyre dhe per gjenenruar fatuart), FLARE HR & Payroll (modul qe sherben per te menaxhuar te dhenat e punonjesve dhe gjithashtu per te llogaritur pagat e tyre). Kjo shoqeri ka nje numer prej 120.000 abonentesh dhe ofron sherbimin e saj per abonentet ne te gjitha njesite qe ajo administron (Durres, Kavaje, Kruje, Shijak dhe Rrogozhine). Sistemi FLARE ERP është në funksion që nga viti 2012 dhe përmban të gjithë historikun e të dhënave të abonentëve të Shoqërisë. Me krijimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Durrës, të gjitha të dhënat historike të njësive të mëparshme të administrimit (Durrës, Kavajë, Krujë, Shijak dhe Rrogozhinë) janë migruar dhe konsoliduar brenda këtij sistemi, duke siguruar integritetin dhe vazhdimësinë e informacionit për të gjithë abonentët në territorin e mbuluar nga Shoqëria. Ky sistem gjithashtu është i integruar me palet e treta sic janë Banka dhe institucione te tjera financiare per te bere te mundur qe abonentet e kesaj shoqerie te bejne pagesa si online ashtu edhe prane sporteleve te ketyre institucioneve. Gjithashtu sistemi është i integruar edhe me sistemin e Bashkise Durres per te bere te mundur kalimin e informacioneve fianaciare nga njeri autoritet ne tjetritn. Infrastruktura e shoqerise është pjese e infrastrukturave kritike dhe auditohet nga AKSK ne periudha te ndryshme duke marre dhe rekomandimet e saj. Kjo procedurë ka për qëllim sigurimin e mirëmbajtjes së vazhdueshme teknike dhe funksionale të sistemit FLARE ERP, në përputhje me rekomandimet e Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK) dhe standardet teknike të përcaktuara nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI). Objektivi kryesor është të garantohet:

- Vazhdimësia dhe cilësia e shërbimit ndaj abonentëve;
- Siguria, integriteti dhe besueshmëria e të dhënave të përpunuara nga sistemi;
- Zbatimi i praktikave më të mira të teknologjisë së informacionit, përfshirë përditësimet dhe përmirësimet e nevojshme të komponentëve ekzistues.

Qëllimi

Qëllimi i këtij projekti është instalimi i licensave 1 vjecare te Flare ERP dhe mirembajtja ne kushte pune optimale e sistemit.

2. REZULTATET QË DUHET TË ARRIHEN

Rezultatet konkrete që duhet të arrihen nga operatori ekonomik:

- Dorezimi dhe instalimi i licensave te reja 1 vjecare per komponentet e Flare ERP qe te perfshijne edhe funksionimin e site Disaster Recovery;
- Mirembajtja e te gjithë perberesve te Flare ERP ku perfshihen rregullimet e keqfunksionimeve dhe update i vazhdueshem i komponenteve teknologjike sa here eshte i nevojshem;
- Mirembajtja e App mobile per PDA te lexuesve;
- Mirembajtja e integrimi me institucionet Banke dhe jo Banke, Bashkise Durrës;
- Krijimi i nje site Disaster Recovery ne cloud.

3. SUPOZIMET DHE RISQET

Faktori kyc i finalizimit me sukses të këtij projekti analizimi i kujdesshëm i proceseve ekzistuese të punës dhe sistemeve aktuale. Bashkëpunimi me stafin e departamentit të IT-së së Shoqerise Rajonale do të lehtësojë mbledhjen e informacioneve të duhura rreth sistemeve ekzistuese.

a. Supozimet e Projektit

Faktori kyc i finalizimit me sukses të këtij projekti eshte analiza e kujdesshme e proceseve egzistuese te punes, sistemit aktual dhe kryerja e testeve te ngarkeses. Zbatimi i teknikave te optimizimit te transmetimit te te dhenave, procesimit paralel dhe parimeve te sigurise se informacionit mbeten kritike per arritjen e objektivave te projektit.

b. Risqet

- Mos analiza e mire e proceseve aktuale te punes
- Keq interpretimi i faktoreve qe ndikojne ne performancen e sistemit
- Humbja e informacionit si pasoje e modifikimeve ne sistemin egzistues

4. KËRKESAT FUNKSIONALE

Instalimi i licensave te reja 1 vjecare dhe mirembajtja e sistemit FLARE ERP per modulet FLARE Billing, FLARE HR & Payroll, Mobiread bashke me aplikacionin mobile. Mirembajtja e integrimi te ketij sistemi me palet e treta.

Mirembajtja duhet të përfshijë garantimin e shërbimit të sistemit sipas parashikimeve në kontratë.

Kerkesat për Disaster Recovery në Cloud

Në një kohë kur disponueshmëria dhe integriteti i të dhënave janë kritike për operimin e vazhdueshëm të sistemeve digjitale, ndërtimi i një ambienti të besueshëm për **Disaster Recovery (DR)** është jo vetëm një praktikë e rekomanduar, por një domosdoshmëri. Qëllimi kryesor i një sistemi DR është të sigurojë vazhdimësinë e shërbimeve dhe rikuperimin sa më të shpejtë të funksionaliteteve thelbësore të një aplikacioni WAb pas një ndërprerjeje të paparashikuar, qofshin këto ndërprerje natyrore, teknologjike apo njerëzore.

Zbatimi i një zgjidhjeje të mirëfilltë për DR garanton mbrojtjen e të dhënave, minimizimin e kohës jashtë funksionit dhe ruajtjen e besimit të përdoruesve dhe partnerëve të jashtëm. Një sistem DR i planifikuar mirë ndihmon organizatat të shmangin humbje financiare, të respektojnë kërkesat ligjore dhe të mbajnë ritmin dhe vijueshmërinë e punës së perdritshme. Më tej, DR kontribuon në një arkitekturë më elastike dhe të përshtatshme për zgjerim dhe përballje me sfida të paparashikuara operacionale. Parametrat më të rëndësishëm për ambientin DR janë **RTO (return to operation)** i cili nënkupton kohën e duhur për të vendosur në punë ambientin DR dhe **RPO (recovery point origin)** i cili nënkupton sa të freskëta duhet të jenë të dhënat që restaurohen pas një ndërprerjeje të shërbimit në ambientin primar.

Arkitektura e ambientit DR

Mjedisi aktiv është ai në të cilin aplikacioni operon normalisht dhe përmban të gjithë komponentët funksionalë: aplikacionin, bazat e të dhënave, shërbimet mbështetëse dhe mjetet e monitorimit dhe të mbrojtjes nga sulmet kibernetike. Ndërkohë, ambienti DR – kerkohet të vendoset në një server cloud të dedikuar për këtë qëllim – ky server duhet të përmbajë një kopje të sinkronizuar të konfigurimit dhe të dhënave kritike.

Kerkohet që të përmbushet **RTO prej 15 minutash**, kështuqë arkitektura duhet të parashikojë që në ambientin cloud të jenë të gatshme instanca-t e nevojshme që mund të aktivizohen automatikisht (ose me ndërhyrje minimale) sapo detektohet një ndërprerje. Ky aktivizim përfshin ngarkimin e versionit më të fundit të aplikacionit dhe lidhjen me bazat e të dhënave të replikura.

Kerkohet gjithashtu të garantohet **RPO prej 8 orësh**, duke implementuar një mekanizëm replikimi asinkron për bazat e të dhënave, ku të paktën çdo 8 orë realizohet një backup i plotë

dhe transferohet në ambientin DR, ne cloud. Në raste kritike, rikuperimi do të bazohet në këtë pikë të fundit të sigurt të të dhënave. Ky kompromis i përballueshëm midis frekuencës së replikimit dhe kapacitetit të ruajtjes është në përputhje me kërkesat operacionale dhe kapacitetet teknike aktuale dhe garanton që veprimtaria e perdritshme e punës me sistemin të mos ndikohet nga veprimet e sinkronizimit midis dy ambjenteve.

Është thelbësore të sigurohemi që ambienti DR **jo vetëm ekziston**, por që është **gjithmonë gati për t'u aktivizuar** në rast emergjence. Kjo arrihet përmes monitorimit të përhershëm, testimeve të rregullta dhe një procesi të qartë raportimi të vlefshmerisë, RTO dhe RPO pas çdo testimi.

Gjendja e ambientit DR duhet të jetë gjithmonë nën kontroll. Për këtë arsye, duhet të përdoren sisteme monitorimi që mbikëqyrin 24/7 funksionimin e të gjithë komponentëve: rrjetin, serverët, databazat dhe procesin e replikimit të të dhënave.

Nëse ndodh ndonjë problem — për shembull, replikimi ndalon apo ndonjë server nuk është aktiv — sistemi do të dërgojë menjëherë sinjalizime (alerts) tek ekipi teknik përmes email-it. Synimi është të kemi ndërhyrje sa më të shpejtë dhe të mos lejojmë që një defekt i vogël të shndërrohet në problem të madh.

Ambjenti DR duhet ta testohet rregullisht për t'u siguruar që funksionon siç duhet në praktikë, jo vetëm në teori. Kjo duhet të realizohet me testime të planifikuara, ku duhet të provohet nëse DR mund të marrë përsipër ngarkesën në rast se ambienti primar dështon.

Testimi duhet të realizohet i plotë me simulime situatash ku aplikacioni kalon përkohësisht në ambientin DR. Këto testime do të bëhen **të paktën dy herë në vit**, në periudha të përcaktuara dhe pa rrezikuar shërbimin aktual.

Dokumentimi dhe vlerësimi i funksionimit të DR

Pas çdo testimi, duhet të përgatitet një raport i plotë. Ky raport do të tregojë nëse DR ka funksionuar siç pritej, sa kohë është dashur për aktivizim, nëse ka pasur ndonjë problem dhe çfarë mund të përmirësohet. Ky proces dokumentimi është i rëndësishëm për të pasur prova konkrete që DR është funksional dhe për të përmbushur çdo kërkesë të mundshme për auditim apo verifikim nga palët e treta.

Siguria e ambientit DR

Është shumë e rëndësishme që ambienti DR të jetë jo vetëm funksional, por edhe **i sigurt**. Në situata emergjente, kur DR aktivizohet, rreziku nga keqpërdorimet, gabimet njerëzore ose

sulmet kibernetike është më i lartë. Prandaj, kërkojme masa të qarta sigurie dhe zbatimin e politikave strikte për kontrollin e qasjes në këto ambient. Konkretisht, kërkojme të realizohet:

- Monitorimi i burimeve të ambientit DR për të garantuar disponueshmëri të plotë.
- Instalimi dhe konfigurimi i WAF (Web application firewall) për mbrojtje nga sulmet në nivel të WAb aplikimit duke përfshirë por pa u kufizuar në OWASP Top 10.
- Instalimi dhe konfigurimi i sistemit të mbledhjes dhe menaxhimit të ndodhjeve të regjistruara në çdo perberës të infrastruktures mbështetëse dhe vetë aplikimit.
- Instalimi dhe konfigurimi i sistemit për njohjen dhe adresimin e kërcënimeve kibernetike duke përfshirë konfigurimin e përgjigjeve të menjehershme apo “active response”.
- Në përfundim të përgatitjes së ambientit DR duhet të realizohet testim i përgjithshëm i sigurisë Pen-Test duke përfshirë black-box dhe white-box testing. Këto teste duhet të përsëriten pas çdo deploy në ambientin DR.

Për çdo version të ri të WAb aplikimit duhet të realizohet deploy edhe në ambientin DR. Pas realizimit të deploy duhet të ndiqen të njëjtat procedura të verifikimit të funksionimit të plotë të sistemit në këto ambient me ato që ndiqen për realizimin e verifikimeve në ambientin lokal.

Parametrat e server dhe të shërbimit “cloud”

Për të siguruar funksionimin e qëndrueshëm dhe të sigurt të ambientit Disaster Recovery (DR), kërkohet që infrastruktura cloud që do të përdoret të përmbushë një sërë parametrash teknike dhe standardesh të shërbimit. Këta parametra janë të përcaktuar për të garantuar performancë të lartë, disponueshmëri të vazhdueshme dhe përputhshmëri me ligjet dhe rregulloret për sigurinë kibernetike dhe mbrojtjen e të dhënave, duke reflektuar nevojat specifike të aplikacioneve kritike për përdorim në kontekste shtetërore dhe institucionale.

Serveri ose shërbimi cloud i zgjedhur duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

Të ofrojë kapacitet ruajtjeje afatgjatë prej së paku 1TB, për të garantuar ruajtjen e të dhënave të replikimit dhe backup-eve pa kufizime kritike duke u nisur nga kapaciteti aktual në përdorim.

Të ketë memorie kryesore (RAM) të paktën 32GB, për të përballuar ngarkesën e proceseve të aplikacionit dhe të shërbimeve të sistemit.

Të ketë procesor me së paku 16 bërthama (core), secila me frekuencë jo më pak se 2GHz, për të siguruar performancën e nevojshme në rast aktivizimi të ambientit DR.

Të jetë i pajisur me një sistem operimi Linux në versionin më të fundit LTS (Long-Term Support) ose një alternativë ekuivalente, e njohur për stabilitet dhe siguri në nivel enterprise.

Të ketë të aktivizuar backup automatik ditor, me funksionalitet të kontrollit dhe verifikimit të rregullt të backup-eve, për të garantuar rikuperim të saktë dhe të sigurt të të dhënave.

Të jetë i besueshëm për përdorim në kontekste shtetërore dhe qeveritare, me përputhshmëri të plotë me GDPR, si dhe i pajisur me certifikatat ISO/IEC 27001 për menaxhimin e sigurisë së informacionit dhe ISO/IEC 27701 për menaxhimin e privatësisë së të dhënave.

Meqenese site DR do te funksionojë ne Cloud dhe ai është i një rëndesie të vecante si për ndërrmarjen ashtu edhe për Republikën e Shqipërisë, bazuar në ligjin Nr. 25/2024, OE duhet të kryejë të gjitha instalimet dhe konfigurimet e nevojshme duke patur parasysh sigurinë e të gjithë sistemit dhe të Cloud ku site DR operon. Të gjithë kërkesat e mirëmbajtjes së sistemit vlejne edhe për site DR.

Licensat e Flare ERP duhet të përfshijnë edhe funksionimin e site DR. Në rast të kalimit në përdorim live të site DR, Flare ERP duhet të funksionojë me të gjithë funksionalitetet që ai ka aktive në site primar.

5. LOGJISTIKA DHE KOHA

5.1. Vendndodhja

Baza operative e projektit do të jetë në Durrës.

5.2. Data e Fillimit dhe Periudha e Implementimit të Detyrave

Data e fillimit të projekti do të jetë dita e nesërme e punës pas nënshkrimit të kontratës me operatorin ekonomik apo bashkimin e operatorëve fitues të këtij projekti dhe periudha e mirëmbajtjes do të mbulojë 12 muaj.

6. RAPORTIMI

6.1. Kërkesat për Raportimin

Kontraktuesi do të paraqesë raportin e aktiviteteve të mirëmbajtjes mujore tek ndjekësit e kontratës të miratojnë raportin e mirëmbajtjes. Raporti duhet të jetë në gjuhën shqipe në origjinal dhe 1 kopje.

Karakteristika të Flare ERP:

- Kategoria e zgjidhjes: ERP;
- Modulet e përfshira:

- Faturim dhe arketim
- Lexim i matesave nepermjet PDA
- Burime njerezore dhe llogaritje pagash
- Integrim i ndersjellte mes te gjithe moduleve, etj;
- Pronesia intelektuale: SHRUK Durres nuk zoteron pronesine intelektuale te zgjidhjes dhe as te drejten e autorit, ato jane pronesi e prodhuesit/autorit;
- Database: MySql;
- Gjuhet e programimit: PHP, Node.js, Javascript (obviajs.com), HTML, Bootstrap, CSS, Java per Android;
- WAb server: Apache WAb server;
- Server i raporteve: Apache tomcat;
- Sistem operimi: Ubuntu Linux;
- Firewall: Iptables, ufw;
- Deploy management: Jenkins;
- Api dhe WAb sherbime: SOAP, REST, xml.

7. Mirembajtja

- Te mirembaje sistemin me te gjithe modulet perberes bashke me aplikacionin e PDA (lexuesve mobile te matesave) sipas SLA-s te parashikuar ne kontrate duke u pergjigjur ne kohe per cdo problem qe raportohet nga ana e stafit te shoqerise;
- Te kryeje update te komponenteve teknike kur eshte e domosdoshme;
- Te rregulloje keqfunksionimet e sistemit qe mund te shfaqen gjate punes dhe te raportuara nga perdoruesit;
- Te mirembaje integrimin e sistemit me institucionet Banke dhe jo Banke per pagesat e abonenteve e cila realizohet nepermjet protokolleve te njohura si psh SOAP, REST etj. Mirembajtja te garantoje siguri per sherbimet WAb (SOAP/REST/XML-Rpc) bazuar ne autentifikim ne dy nivele dhe komunikim te enkriptuar per tu dhene mundesi agjenteve te jashtem te komunikojne ne menyre te sigurt;
- Te mirembaje integrimin me sistemin e Bashkise Durres;
- Te dorezoje raportet e mirembajtjes sipas afateve te vendosura ne planin e punes.

Ne tabelen e meposhtme percaktohet kategorizimi i seriozitetit te problemeve dhe koha e pergjigjes per zgjidhjen e tyre :

Kategoria A (Kritik/ I Larte)	Kategoria B (I Mesem)	Kategoria C (I Ulet)
Mos funksionimi i programit krijon apo rrezikon shumë aktivitetin normal	Mos funksionimi i programit krijon vonesa në aktivitetin normal	Mos funksionimi i programit pengon në mënyrë minimal aktivitetin

Numri i përdoruesve të ndikuar		
Mosfunksionimi i programit ndikon një numër <i>shumë të madh</i> të përdoruesve	Mosfunksionimi i programit ndikon një numër <i>të vogël</i> të përdoruesve	Mosfunksionimi i programit ndikon pjesërisht në disa përdorues
Pezullimi i punës		
Mosfunksionimi i programit pengon përdoruesit <i>të realizojnë pjesën më të madhe të punës së tyre.</i>	Mosfunksionimi i programit pengon përdoruesit <i>të realizojnë pjesë të punës së tyre</i>	Mosfunksionimi i programit pengon përdoruesit <i>të realizojnë disa pjesë të vogla të punës së tyre,</i>
Zgjidhje alternative e përkohshme		
<i>Nuk ka një mënyre alternative</i> të përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit	<i>Ka pjesërisht një mënyre alternative</i> të përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit.	<i>Ka një mënyrë alternative</i> të përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit.
Koha e përgjigjes		
○ 30 min. për të kthyer përgjigje	○ 30 min.për të kthyer përgjigje	○ 30 min.për të kthyer përgjigje
Koha e zgjidhjes		
Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është 24 orë pas kërkesës.	Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është brenda 2 ditëve të punës.	Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është 10 ditë kalendarike.

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

➤ Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

➤ Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 **Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas Formularit përmbledhës të vetdeklarimit

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiar **2022, 2023 dhe 2024**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2022, 2023 dhe 2024** të konfirmuara nga administrata tatimore, ku të paktën në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se **40% të vlerës** së së fondit të limit të përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik **për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe faturave tatimore të shitjes dhe të deklaruara ne organet tatimore, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi**, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes **të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara ne organet tatimore**, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.3.2 Për të vërtetuar që ka kapacitete njerezore, profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë dhe sipas specifikimeve teknike të projektit, operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar të paktën 6 (gjashtë) punonjës të diplomuar në fushën e IT (inxhinieri informatike, informatike ekonomike, shkencë kompjuterike etj), si mëposhtë:

- a) Të paktën 3 (tre) punonjës ku një të jetë i certifikuar nga prodhuesi në zhvillimin e Flare Billing ose ekuivalent, një të jetë i certifikuar nga prodhuesi në zhvillimin e Mobiread ose ekuivalent, një të jetë i certifikuar nga prodhuesi në zhvillimin e Flare HR & Payroll ose ekuivalent.

-
- b) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për Certified SOA Professional (profesionist i certifikuar për arkitekturë orientuar nga shërbimet) ose ekuivalent.
 - c) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si menaxher projekti PMP ose ekuivalent.
 - d) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për menaxhimin e shërbimeve IT (ITIL ose ekuivalente).
 - e) Të paktën 1 (një) punonjës të Çertifikuar për Implementimin dhe Menaxhimin e Sistemeve të Sigurisë së Informacionit (CISM ose ekuivalent).
 - f) Të paktën 1 (një) punonjës të Çertifikuar si Auditor i Sistemeve të Informacionit (CISA ose ekuivalente).
 - g) Të paktën 1 (një) punonjës të Çertifikuar si Profesionist në Sigurinë Ofensive (OSCP ose ekuivalente).

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

1. Diplomat e shkollës së lartë
2. Certifikatat/transkriptet që vërtetojnë certifikimet e mesiperme të kerkuara
3. Formularët E-SIG për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit duke iu referuar datës së zhvillimit të procedurës

Shënim: Një punonjës mund të disponojë edhe më shumë se një certificate.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar, i pari do të dorëzojë dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatori ekonomik duhet të disponojë Certifikatat për standardet e mëposhtëme, të lëshuara nga organizma të akredituara për këtë qëllim, në përputhje me objektin e prokurimit të kësaj procedure:

- Certifikatën ISO 9001:2015 standardi i menaxhimit të cilësive (ose ekuivalente e perditësuar)
- Certifikatën 27001:2017 standardi i sigurisë së informacionit (ose ekuivalente)
- ISO 20000 (manaxhimi i shërbimeve IT) e cila duhet të përkojë me kategorinë dhe specifikën e produkteve dhe të shërbimeve që prokurohen. (ose ekuivalente)

2.4.2 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Autorizimin nga Prodhuesi/distributori, ku të autorizohet operatori për shitjen e licensave të produkteve software dhe kryerjen e

sherbimeve të përfshira në këtë objekt prokurimi për territorin e Shqipërisë. Në rast të paraqitjes së autorizimit të Distributorit të verifikohet lidhja mes Prodhuesit dhe Distributorit. Dokumentacioni të jete ne gjuhen shqipe si dhe te kete te gjithë kontaktet (nr telefoni, E-mail) si dhe adresen WAb te prodhuesit apo Distributorit per konfirmim te dokumentave te paraqitura. Te jete e percaktuar emri, nipt dhe adresa fizike e operatorit ekonomik. Autorizimi te kete edhe daten e leshimit perpara dates se zhvillimit te tenderit.

2.4.3 Operatori Ekonomik duhet te jete i çertifikuar ose partner zyrtar i cloud ku do të ofrohet shërbimi. Të vërtetohet nëpërmjet një dokumenti zyrtar të lëshuar nga ofruesi i shërbimit Cloud, i verifikueshëm, ose nëpërmjet shfaqjes në WAbsite zyrtar të ofruesit të shërbimit Cloud i emrit dhe detajeve të O.E.

2.4.4 Operatori Ekonomik duhet te dorezoje nje propozim teknik per implementimin, mirembajtjen dhe funksionimin e site Disaster Recovery dhe te permbushjes se te gjithë kerkesave teknike.

2.4.5 Operatori Ekonomik duhet te dorezoje dokumenta zyrtare te leshuara nga organizata qe ofron sherbimin cloud ose link ne WAbsite zyrtar te sherbimit cloud te ofruar per site DR ku verteton qe cloud i perzgjedhur ploteson kerkesat per:

- Të jetë i besueshëm për përdorim në kontekste shtetërore dhe qeveritare,
- Me përputhshmëri të plotë me GDPR,
- I pajisur me certifikatat ISO/IEC 27001 për menaxhimin e sigurisë së informacionit,
- I pajisur me ISO/IEC 27701 për menaxhimin e privatësisë së të dhënave.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

